

13.02.2022

Ora 12:15

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 3,
dt.12.02.2022, subjekti ankues Partia Lëvizja e Re”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, sot në datën 13.02.2022, po zhvillojmë seancën për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 3, datë 12.02.2022, ora 21:15. Procedura e shortit do të jetë e njëjtë si në procedurat e tjera. Kërkesa Ankimore Nr. 3 me ankues Lëvizjen e Re (LRE). Objekt i ankimit është “Kundërshtim i vendimit nr. 72, datë 12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës e subjektit zgjedhor LRE për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Jonid Mano, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Procedura e shortit do të zhvillohet sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre të bardhë, në një të njëjtë prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 3. Shiritat palosen dhe vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas vendosen në një enë transparente. Një përfaqësues i KQZ-së do t’i tregojë e palosë para kamerave të katër shiritat e bardhë dhe shiritin ku është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 3. Duke qenë se seanca e shortit zhvillohet pa praninë e anëtarëve të KAS-it, kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.02.2022*

autorizuar administratën e KQZ-së që të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre goglat për të caktuar relatorin e Kërkesës Ankimore nr. 3.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilir Rusmali – Kërkesa Ankimore nr.3.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit, relator i Kërkesës Ankimore nr. 3, do të ketë relator zotin Ilirjan Rusmali, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

